



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë: 18.03.2025

**THIRRJE PUBLIKE PËR DY ANËTARË (EKSPERT) TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR
MASËN 4. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR AKTERËT TJERË TË ZHVILLIMIT SOCIO -
EKONOMIK RAJONAL**

NËN MASA 4.1. MBËSHTETJE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Hyrje

Ministria e zhvillimit Rajonal ka hapur thirrjen publike për projekt propozimet e Organizatave të Shoqërisë Civile që kanë për qëllim avancimin e zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar. Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) u bënë thirrje të gjitha anëtarëve nga organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Kosovës si dhe ekspertëve shtetas në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e zhvillimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me zhvillimin socio - ekonomik rajonal të balancuar, që të aplikojnë për pjesëmarrje në komisionin e vlerësimit të projekt propozimeve të OSHC-ve që aplikojnë për këtë thirrje për propozime.

Thirrje për dy anëtarë

Në kuadër të thirrjes për projekt-propozime, sipas Nenit 8 (3.2) të Rregullores MF - nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, MZHR hap këtë thirrje publike për zgjedhjen e dy përfaqësuesve nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve.

Detyrat e Komisionit Vlerësues

Detyrat e Komisionit Vlerësues janë të përcaktuara me **Rregulloren MF-Nr. 04/2017**, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve. Komisioni Vlerësues ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- të vlerësojë aplikacionet nga aspekti procedural sipas rregullores;
- të vendos nëse aplikantët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të parapara me rregullore për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike;
- të shqyrtojë dhe vlerësojë aplikacionet/propozimet e aplikantëve të kualifikuara për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtësor;
- të sigurojë që projektet/programet e përzgjedhura për mbështetje financiare i plotësojnë të gjitha kriteret e thirrjes publike, dhe kontribuojnë arritjes së prioriteteve dhe objektivat e thirrjes;
- të kërkoj dokumentacion shtesë të nevojshëm nga aplikuesit pas publikimit të listës paraprake të përfituesve dhe para nënshkrimit të kontratës;
- të përzgjedh përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike.

Pjesëmarrja në Komisionin Vlerësues bëhet me pagesë, në shumë prej 266.20 euro.

Kualifikimet

Për të qenë anëtarë të Komisionit Vlerësues, aplikantët duhet të përmbushin këto kualifikime:

- Të kenë përfunduar suksesshëm studimet universitare në fushën e shkencave shoqërore, juridik, apo ekonomisë dhe biznesit;
- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune në fushat relevante me thirrjen për propozime;
- Të ketë përvojë në vlerësimin e projekteve, skemave të granteve ndërkombëtare, vendore apo në hartimin apo vlerësimin e projekt propozimeve;
- Të ketë përvojë në një apo më shumë fusha prioritare që mbulon thirrja përfshirë punë me të rinjë, promovimin e platformave online apo zhvillimit të ekonomisë apo biznesit;
- Të kenë fleksibilitet kohor për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit Vlerësues sipas kërkesave të MZHR-së gjatë muajit Mars - Prill 2025.

Rregulla të përgjithshme për përmbushjen e kualifikimeve: Anëtarët e Komisionit Vlerësues nuk mund të jenë të emëruarit politik. Secili nga anëtarët e Komisionit Vlerësues nënshkruan deklaratën mbi paanshmërinë dhe konfidencialitin në vendimmarrje. Anëtarët e emëruar të Komisionit Vlerësues duhet paraprakisht të sigurohen që pjesëmarrja e tyre në këtë komision është në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit, duke nënshkruar një deklaratë me të cilën deklarojnë se nuk ekziston konflikt interesi. Në rast të ekzistimit të konfliktit të interesit, anëtarët duhet të kërkojnë nga udhëheqësi zëvendësimin e tyre.

Dorëzimi i aplikacioneve

Ju lutem të dorëzoni CV apo resumen tuaj, dëshmitë për kualifikimet profesionale si dhe referencat për përvojën e punës jo më vonë se 03.04.2025 në e-mailin:

shkrimorja.MZHR@rks-gov.net